

20110421124

## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6, në pajtim me nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010) Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

### **V E N D I M PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR ZBULIMIN DHE TËRHEQJEN E PARAVE TË FALSIFIKUARA**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

1. Me këtë vendim përcaktohet procedura për zbulimin dhe tërheqjen e parave të falsifikuara të shprehura në denarë ose valutë të huaj, mënyra e raportimit në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore), ekspertiza, regjistrimi dhe bashkëpunimi me institucionet në vend dhe jashtë vendit.

2. Terme të caktuara brenda këtij vendimi kanë kuptimin si vijon:

- para të falsifikuara: kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara janë para të cilat nuk emetohen nga autoriteti kompetent, të cilat janë të rreme apo ndryshe, por që kanë pamjen e kartëmonedhave dhe monedhave autentike të shprehura në denarë ose në valutë të huaj, me qëllim që të bëhen mashtrime dhe për t'u shfaqur si para origjinale.

- ekspertizë: përgatitja e një mendimi profesional, i përpunuar në bazë të metodave, njohurive dhe përvojave profesionale, me anë të së cilit vërtetohet autenticiteti i kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta të shprehura në denarë ose në valutë të huaj dhe karakteristikat e tyre individuale.

- prurës të ekzemplarëve të dyshimtë të parave: janë institucionet në vend që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë hyjnë në kontakt me paratë e gatshme - institucionet financiare, Ministrinë e Punëve të brendshme (MPB), Drejtorinë Doganore të RM-së pranë Ministrisë së Financave, Drejtorinë e Policisë Financiare pranë Ministrisë së Financave.

- njësi organizative për ekspertizën e falsifikimeve: njësi organizative e veçantë e krijuar brenda Bankës Popullore, qëllimi kryesor i së cilës është përqendrimi integral i aktiviteteve për parandalimin e falsifikimit dhe zbulimin e falsifikimeve, kryerje të ekspertizës së kartëmonedhave dhe monedhave të shprehura në denarë ose në valutë të huaj, si dhe bashkëpunimin me institucionet relevante në vend dhe jashtë vendit për shkëmbimin e informacioneve.

#### **II. Procedura për zbulimin e parave të falsifikuara në institucionet financiare dhe institucionet tjera**

3. Institucioni financiar në kontakt me paratë e gatshme, përveç vërtetimit të numrit të saktë të parave të pranuar, është i obliguar të identifikojë edhe ekzistencën e parave të falsifikuara.

4. Gjatë pranimit të parave të gatshme, institucioni financiar është i detyruar ti ruaj ekzemplarët e dyshimtë dhe ti jep një vërtetim personit nga i cili janë konfiskuar, me paralajmërim se ekziston dyshim për falsifikim. Në vërtetim duhet të shënojnë të dhënat

personale të personit nga i cili është konfiskuar ekzemplari i dyshimtë, si dhe një deklaratë të shkurtër për origjinën e ekzemplarit të dyshimtë të konfiskuar.

5. Gjatë përpunimit të parave të gatshme nga institucioni financiar, për më tepër mundet edhe të identifikohet ekzistimi i një ekzemplari të dyshimtë të parave.

6. Në institucionin financiar ekzemplar të dyshimtë të parave mund të paraqes person fizik ose juridik, me qëllim të përcaktimit të autenticitetit të tyre. Në një rast të tillë, institucioni financiar vepron ashtu siç është paraparë në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Në rast se institucioni financiar nuk arrin të zbulojë mostrën e dyshimtë të parave gjatë pranimit dhe përpunimit të parave të gatshme, ajo mund të përcaktohet gjatë përpunimit të parave të gatshme të dorëzuara në Bankën Popullore nga institucioni financiar.

8. Në të gjitha rastet e zbulimit të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta përgatitet procesverbal në të cilin deklarohen elementet e mëposhtme:

- emri i institucionit i cili dyshon në autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave;
- data e zbulimit të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta;
- emri dhe mbiemri i personave të cilët zbuluan kartëmonedhat dhe monedhat e dyshimta;
- numri i copave dhe struktura e denominimit;
- përshkrim i shkurtër i ngjarjes;
- nënshkrimi i personave të autorizuar të institucionit.

Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshimta të cilat janë zbuluar, së bashku me një kopje të verifikuar të procesverbalit, dërgohen për analizë profesionale në Bankën Popullore, në njësinë organizative për ekspertizën e falsifikimeve.

9. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Drejtoria Doganore e RM-së pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtoria e Policisë Financiare pranë Ministrisë së Financave veprojnë me ekzemplarët e dyshimtë të zbuluara të parave në përputhje me procedurat e tyre të përcaktuara dhe për ta paraqesin njoftim me shkrim, kërkesë deri te Banka Popullore për kryerje ekspertizë profesionale.

### **III. Procedura në Bankën Popullore**

10. Kartëmonedhat ose monedhat e dyshimta të paraqitura nga prurësit e ekzemplarëve të parave të dyshimta i nënshtrohen ekspertizës në Bankën Popullore.

Ekspertiza e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshimta ka për qëllim:

- të vërtetojë nëse në rastin konkret bëhet fjalë për falsifikim;
- t'i përcaktoj karakteristikat individuale të falsifikimit;
- të jepi përshkrim të llojit dhe tipit të falsifikimit, vlerën nominale, datën e lëshimit, numrin serik, mënyrën e përpunimit të falsifikimit, si dhe elementet mbrojtëse të letrës nga e cila është bërë kartëmonedha e falsifikuar, d.m.th. elementet përzierjes së monedhave të falsifikuara;
- të hartojë një përshkrim të falsifikimit të ri i cili do t'u ofrohet të gjitha institucioneve financiare, dhe në veçanti një përshkrim me të cilin do të informohet publiku;
- të përcaktojë llojin dhe tipin e falsifikimit të ri dhe shenjën e tij të nevojshme dhe
- të saktësoj, në qoftë se bëhet fjalë për një falsifikim tashmë të njohur, se çfarë lloji të falsifikimit i takon ekzemplari përkatës.

11. Nëse përcaktohet se ekzemplarët e dyshimtë të cilat janë paraqitur janë të vërtetë, ato u kthehen prurësve të ekzemplarëve të parave të dyshimta, së bashku me raportin e ekspertizës së kryer.

12. Banka Popullore i tërheq kartëmonedhat ose monedhat e dyshimta të cilat janë dorëzuar për ekspertizë, dhe për të cilët vërtetohet se janë para të falsifikuara.

#### **IV. Mbajtja e evidencës së kërkuar në Bankën Popullore**

13. Banka Popullore mban evidencë për falsifikimet e parave që kanë të bëjnë me:

- prurësit e ekzemplarëve të parave të dyshimta;
- data e pranimit;
- lloji i falsifikimit - kartëmonedha ose monedha;
- vlera nominale;
- data e lëshimit;
- numri serik;
- lloji i letrës nga e cila është prodhuar falsifikimi;
- lloji i falsifikimit - metoda e prodhimit të falsifikimit;
- numri i copave dhe struktura e denominimit;
- data e raportimit tek prurësit e ekzemplarit të parave të dyshimta dhe
- data e raportimit në MPB.

Paratë e falsifikuara mbahen në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit të Bankës Popullore 10 (dhjetë) vite, dhe pas skadimit të afatit ato shkatërrohen sipas një akti të miratuar nga Guvernatori ose personi i autorizuar nga Guvernatori.

#### **V. Marrëdhëniet e Bankës Popullore me Ministrinë e Punëve të Brendshme**

14. Kopje e procesverbalit për pranimin dhe identifikimin e falsifikimeve, si dhe raporti mbi ekspertizën e Bankës Popullore, përveç prurësit të ekzemplarit të parave të dyshuara, dorëzohet edhe deri te Ministria e Punëve të Brendshme.

15. Banka Popullore, me kërkesë të gjykatës, për qëllime të hetimit dhe realizimit të procedurës gjyqësore, i vë në dispozicion të gjitha ekzemplarët e falsifikuar të pranuar nga falsifikuesit përkatës që i bashkëngjiten çështjes. Në raste të jashtëzakonshme, për shkak të nevojave të hetimit, ato i dorëzohen Ministrisë së Punëve të Brendshme.

16. Pas përfundimit të procedurës gjyqësore për veprën penale falsifikim të parave, të gjitha ekzemplarët e falsifikuar të dorëzuar duhet t'i kthehen Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit në Bankës Popullore, drejtpërdrejt nga gjykata ose përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### **VI. Njoftim për paraqitjen e falsifikimeve**

17. Në rast të paraqitjes të një lloji të ri të falsifikimit, Banka Popullore në koordinim me MPB-në vendos nëse, kujt dhe në çfarë mënyre jepen njoftimet e nevojshme për paraqitjen e një lloji të tillë të falsifikimit.

18. Në bazë të marrëveshjes së paragrafit 1 të kësaj pike, Banka Popullore jep njoftime adekuate, veçanërisht për institucionet financiare, dhe në veçanti për publikun.

19. Shërbimet përkatëse në institucionet financiare duhet vazhdimisht të kenë parasysh njoftimet e pranuar nga Banka Popullore për falsifikimet e zbuluara, si një paralajmërim në punën e tyre me paratë.

20. Paratë e falsifikuara të shprehura në denarë ose në valutë të huaj mund t'i dorëzohen edhe institucioneve ndërkombëtare, me kërkesën e tyre, dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra.

21. Ky vendim hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/III-1/2011  
31 mars viti 2011  
Shkup

Guvernator dhe Kryetar  
i Këshillit të Bankës Popullore  
të Republikës së Maqedonisë  
Petar Goshev